

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ragip Namani, kryetar, Hasan Shala e Ramiz Kuqi, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit H.M. nga Prishtina „rr.”H.R.”nr.36/18, kundër Aktvendimit nr.04-07-11145 të datës 17.09.2009 e të paditurës Drejtoria për financa dhe pronë e Komunës së Prishtinës, me bazë juridike tatim në pronë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për çështje Administrative A.nr.498/10, të datës 17.09.2013, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 14.03.2014, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit H.M. , ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për çështje Administrative A.nr.498/11, i datës 17.09.2013, Vërtetohet.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për çështje Administrative, me aktgjykimin A.nr.498/11, të datës 17.09.2013, e refuzon si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit H.M., të ushtruar kundër të paditurit Drejtoria për financa dhe pronë e K.Prishtinës, me të cilin ka kërkuar anulimin e vendimit të paditurës, me nr.04-07-11145, të datës 17.09.2009.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor paditësi ka ushtruar ankesë dhe plotësim ankesë ,për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të drejtës materiale dhe propozon që ankesa e tij të aprovohet dhe i njëjti të lirohet nga pagesa e tatimit në pronë ose aktgjykimi i goditur në anulohet dhe lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

Gjykata e Apelit, shqyrtoi pretendimet ankimore, aktgjykimin e ankimuar, shkresat e tjera të lëndës , dhe pas vlerësimit të tyre si në vështrim të nenit 49 dhe 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe neni 194 të Ligjit për procedurën kontestimore (LPK), gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se Drejtoria për financa dhe pronë e Komunës së Prishtinës me aktvendimin e atakuar me padi për vitin 2008-2009 e ka anuluar faturën për caktimin e tatimit në pronë në bazë të ankesës së parashtruar nga paditësi si obligues i taksës në pronë.

I pakënaqur me këtë vendim paditësi me padi hap konflikt administrativ në gjykatë me pretendime se shtëpia e vjetër është rrënuar në vitin 2003 kurse ndërtimi i objektit të ri ka filluar në vitin 2004 se organi administrativ nuk ka vendosur sipas thënieve të tij në ankesë dhe propozon që të lirohet nga tatimi në pronë për vitet 2003-2007.

Gjykata Themelore në Prishtinë Departamenti për çështje administrative me aktgjykimin A.nr.498/11, të datës 17.09.2013 e refuzon kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar me arsyetim se për vitet 2003-2007, paditësi nuk ka ushtruar ankesë në organe

administrative ashtu si parashihet me nenin 22 të Rregullores mbi caktimin dhe aplikimin e tatimit në pronë të K. Prishtinë, në faturat vjetore për secilin vit kalendarik brenda afatit ligjor .

Kolegji i Gjykatës së Apelit, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes dhe shqyrtuar aktgjykimin e shkallës së parë në bazë të ankesës së paditësit dhe sipas detyrës zyrtare të njëjtin e konfirmon në tërësi si të drejtë dhe të bazuar në prova dhe ligj. Aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të ligjit për konfliktin administrativ, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 63 të LKA-së, lidhur me nenin 194 të LPK-së, dhe gjykata e shkallës së parë drejtë ka vlerësuar ligjshmërinë a aktit përfundimtar administrativ si në vështrim të nenit 9, dhe 44 të LKA-së., i cili është objekt i shqyrtimit në bazë të kërkesëpadisë.

Gjykata e shkallës së parë duke respektuar rregullat procedurale dhe në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nga organi administrativ ka nxjerr përfundim të ligjshëm andaj pretendimet ankimore të paditësit të cilat konsistojnë në atë “se është liruar vetëm për vitin që ka bërë ankesë e jo edhe për vitet e më parme , se në vitet e më parme nuk ka qen i njoftuar dhe nuk i ka pranuar vendimet e komunës se sipërfaqja e banesave është llogaritar gabimisht dhe objektet kanë qen në ndërtim e sipër”, kolegji vlerëson se pretendimet e tilla nuk janë të bazuara, janë të pa argumentuara dhe nuk e ndryshojnë çështjen në favor të paditësit, sepse baza ligjore përkatësisht dispozitat ligjore të Rregullores mbi caktimin e dhe aplikimin e tatimit në pronë e Komunës së Prishtinës përkatësisht neni 22 dhe 23 i kësaj rregullore është e paraparë se pala ndaj faturës për tatimin në pronë ka të drejtë të parashtrij ankesë brenda afatit prej 30 ditë nga dita e pranimit ,ndërsa e njëjta shqyrtohet nga bordi për ankesa në afat prej 60 ditë nga dita e pranimit të ankesës. Paditësi për vitet 2003-2007,nuk ofron prova në procedurë të rishqyrtimit tek organet administrative dhe as në procedurë gjyqësore se ka parashtruar ankesë, kështu që i njëjti i ka lëshuar afatet ligjore të cilat janë prekluzive për ti kundërshtuar faturat vjetore për tatimin në pronë për vitet për të cilat pretendon 2003-2007.

Mbi këtë gjendje të fakteve gjykata e apelit i shqyrtoi dhe vlerësoi edhe pretendimet e tjera ankimore dhe konstaton se janë të pa ndikim për vërtetimin tjetër të gjendjes faktike nga ajo që është vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë në procedurë gjyqësore dhe nga organet administrative, andaj nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Gjykata e shkallës së parë ka vendosur në baza ligjore si në vështrim të nenit 41 të LKA-së, për mbajtjen e seancës pasi që paditësi mosardhjen në seancë nuk e ka arsyetuar edhe pse ftesa me kohë i është dorëzuar (me datë 26.08.2013),ndërsa edhe në procedurën sipas ankesës nuk ofron prova për pretendimet e tija, gjer sa sipas nenit 56 të LKA, barra e provave për faktet e pretenduara bie mbi palët e interesuara në procedim administrativ, përkundër detyrimit që organet të ofrojnë prova të disponueshme për palët.

Nga të lartë cekurat e si në vështrim të nenit 49 ,63 të LKA, dhe neni 200 i LPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
A.A.nr.383/2013, datë 14.03.2014

Procesmbajtësi,
Bujar Balaj

Kryetari i kolegjit,
Ragip Namani